



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	48374 / 25
Nr. i fq. / Br. st.	2-
Data: / Datum:	11.09.2025
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

THIRRJE PUBLIKE

- Për financimin e projekteve të personave juridik - OJQ-ve, në vlerë mbi 500.00€, nga fusha e Shëndetësisë dhe përkujdesjes Sociale:
11.09.2025

1. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale u bënë thirrje të gjithë Personave juridik - OJQ-ve, të Regjistruara në Republikën e Kosovës të cilat veprojnë në Komunën e Vushtrrisë programi i punës i të cilave është i fokusuar në realizimin e aktiviteteve në fushën e Shëndetësisë dhe përkujdesjen sociale të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në këto fusha për Komunën e Vushtrrisë.

2. Personat juridik - OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

Shëndetësia:

- Programe/projekte për përkujdesje, trajtim të fëmijëve me nevoja të veqanta.
- Edukim shëndetësor të nxënësve dhe komunitetit.
- Programe për parandalimin e sëmundjeve.
- Programe për edukimin shëndetësorë të gruas.

Përkujdesje sociale:

- Projekte nga fusha e përkujdesjes sociale.
- Projekte për pronovimin, mbrojtjen e vlerave të luftës, mbështetjen e viktimave të luftës.
- Projekte për ofrimin e shërbimeve psikologjike dhe sociale për komunitetin.
- Projekte nga fusha e barazisë gjinore dhe sociale.

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 27.000,00euro.

4. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 500,00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 15.000,00 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 02.10.2025.

6. Personat juridik - OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti dy (1) projekte në kuadër të kësaj thirrje publike. Periudha e zbatimit të projektit është brenda vitit kalendarik 2025.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë Personat juridik - OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Vushtrrisë.

Personat juridik - OJQ-të duhet të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale.

Para nënshkrimit të kontratës, Personat juridik - OJQ duhet të paraqesë prova se menaxheri i projektit nuk është nën hetime për vepra penale, si dhe prova se Personat juridik - OJQ-të ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare www.vushtrri.rks-gov.net/

8. Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:
1. Formulari I Aplikacionit për projekt/programit (e shtypur); (F9) 2. Formulari I Propozim buxhetit (e shtypur); (F10) 3. Formulari I deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (e shtypur); (F11) 4. Dokumentacionet e OJQ-së: 4.1 Certifikata e regjistrimit. 4.2 Certifikata e numrit fiskal. 4.3 Dëshmia mbi llogarinë bankare (e shtypur). 4.4 Vërtetimi mbikryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore. 5. Certifikata që nuk është nën hetime për menaxherin e projektit 5.1. Certifikata që nuk është nën hetime përfaqësuesi i autorizuar i organizatës

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht në zarf të mbyllura, në adresën e mëposhtme:
Komuna e Vushtrrisë
Rruga "Adem Jashari"
(zyra e pranimi)

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: naim.ferizi@rks-gov.net.

